


Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës (2023-2028)

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim



*Empowered lives.
Resilient nations.*



Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës (2023-2028)

Grupi i punës:

Prof. Dr. Anila Paparisto
Prof. Asoc. Bernard Dosti
Prof. Dr. Dhurata Shehri
Prof. Dr. Daniela Tamo
Prof. Dr. Eralda Met'hasani
Prof. Dr. Ferdinand Bego
Prof. Dr. Fatos Ylli
Prof. Asoc. Etleva Leskaj
Prof. Asoc. Veronika Duci
Prof. Asoc. Çlirim Duro
Dr. Doris Malaj
Dr. Valbona Ndreppepaj
Dr. Erida Elmazi
Doc. Klesta Hysi
Dr. Desara Agaj
Z. Luan Lapraku
Znj. Ilda Kamberi
Znj. Erinda Caci
Z. Gerald Koçi
Z. Mentor Kikia

Prof. dr. iur. Mišo DOKMANOVIĆ
m.dokmanovic@pf.ukim.edu.mk

Korrik, 2023



Përmbajtja

Hyrje	4
1. Përmirësimi i arsimit dhe novacionit të studimeve	6
2. Rritja e ndërkombëtarizimit dhe lëvizshmërisë	9
3. Përparimi i kërkimit shkencor dhe mbështetja e novacionit përmes qendrave të shkëlqyera kërkimore dhe përmirësimit të renditjes së Universitetit.....	11
4. Përforcimi i angazhimit shoqëror, shtrirjes dhe dukshmërisë	13
5. Mbështetja e promovimit të ekselencës së studentëve, personelit akademik dhe administratës, mbështetja e mirëqenies dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe infrastrukturës.....	15
6. Promovimi dhe mbështetja për sigurimin e cilësisë	18



Hyrje

Universiteti i Tiranës (UT) është universiteti më i madh publik në Shqipëri, i themeluar në vitin 1957. Ai përbëhet nga tetë njësi kryesore organizative: gjashtë fakultete dhe dy institute kërkimore (Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Instituti i Studimeve Evropiane, Instituti i Fizikës Bërthamore të Aplikuar, filiali i Universitetit të Tiranës, në Sarandë), qendra kërkimore dhe 38 departamente administrative. Universiteti ofron programet e mëposhtme: 36 programe të ciklit të parë, 36 programe Master Profesional, 65 programe Master i Shkencave dhe 38 programe të nivelit doktoratë. Në vitin 2022, Universiteti përbëhej nga 779 personel akademik me kohë të plotë dhe 23.551 studentë.

Kuadri bazë për zhvillimin e Universitetit në periudhën 2018-2023 është vendosur përmes dy dokumenteve kyçë të planifikimit dhe zhvillimit strategjik duke përfshirë:

- Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, e cila përvijoi parimet dhe objektivat kryesorë që UT-ja ka përcaktuar për ripozicionimin e rolit të saj në shoqëri dhe përqafimin e të ashtuquajturit Misioni i Tretë i universiteteve dhe
- Plani Strategjik për Kërkimin Shkencor i Universitetit të Tiranës 2018-2022, i cili përvijoi veprimet që UT-ja do të ndërmarrë për të forcuar kapacitetet kërkimore, për të shtuar produktin e saj të kërkimit shkencor, për të zgjeruar rrjetëzimin e fokusuar në kërkime, për të përmirësuar komunikimin shkencor dhe ndarjen e njohurive dhe për të rritur aksesin dhe pjesëmarrjen në forumet e kërkimin ndërkombëtar.

Duke pasur parasysh faktin se kuadri kohor i këtyre dokumenteve përfundoi në fund të vitit 2022 dhe në fillim të vitit 2023, është kryer një vlerësim fillestar i zbatimit të tyre në dhjetor 2022. Rezultatet, mësimet e nxjerra, konkluzionet dhe rekomandimet nga procesi i vlerësimit kanë shërbyer si të dhënët kryesore për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2023-2028). Përveç kësaj, një numër faktorësh dhe prirjesh specifike janë marrë në konsideratë gjatë fazës së hartimit të dokumentit: i) prirjet e zhvillimit të universiteteve kryesore në Bashkimin Evropian dhe Ballkanin Perëndimor; ii) mjedisi i përgjithshëm në sistemin shqiptar të arsimit të lartë duke përfshirë financimin, prirjet e pranimit të studentëve, numrin e personelit të punësuar; iii) sfidat specifike të identifikuara brenda UTsë, etj.

Si rezultat i kësaj, **qëllimi kryesor** i Strategjisë është krijimi i kuadrit për zhvillimin e Universitetit të Tiranës në periudhën 2023-2028 nëpërmjet vendosjes së objektivave, treguesve dhe masave konkrete që duhet të ndërmerren me qëllim që UT-ja të përballojë sfidat e së ardhmes.

Duke pasur parasysh rolin udhëheqës të Universitetit të Tiranës në sistemin shqiptar të arsimit të lartë, numrin e studentëve dhe personelit akademik, diversitetin e programeve Bachelor, Master dhe Doktoratë dhe angazhimin e demonstruar për përparimin e kërkimit shkencor dhe ekselencës akademike, Universiteti mbetet i përkushtuar për të arritur **objektivat** e mëposhtëm:

- ✓ Të përmirësojë arsimin dhe novacionin e studimeve;
- ✓ Të nxitë ndërkombëtarizimin dhe lëvizshmërinë;
- ✓ Të përparojë kërkimin shkencor dhe të mbështetë novacionin nëpërmjet qendrave të shkëlqyera kërkimore dhe të ngrejë renditjen e Universitetit;
- ✓ Të përforcojë angazhimin shoqëror, shtrirjen dhe dukshmërinë;



- ✓ Të mbështetë promovimin e ekselencës së studentëve, personelit akademik dhe administratës, për të mbështetur mirëqenien dhe për të përmirësuar kushtet e punës dhe infrastrukturën;
- ✓ Të promovojë dhe mbështetë sigurimin e cilësisë brenda Universitetit.

Strategjia e Zhvillimit e Universitetit të Tiranës (2023-2028) bazohet edhe në disa dokumente të tjera plotësuese universitare ku përfshihen: Strategjia Institucionale mbi Mësimdhënien e Universitetit të Tiranës (2022-2027); Dokumenti mbi politikat e komunikimit me studentët dhe publikun në Universitetin e Tiranës (2022); Strategjia e Ndërkombëtarizimit e Universitetit të Tiranës, Strategjia e Universitetit të Tiranës për një universitet miqësor ndaj mjedisit (2022-2027) dhe dokumente të tjera të lidhura me to.

Për qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të përbushjes së objektivave dhe treguesve specifikë të kësaj Strategjie, do të zhillohet një Notë Metodologjike specifike për Kryerjen e Vlerësimit të Strategjisë në Universitetin e Tiranës.

Për të arritur objektivat e përcaktuar në Strategji, është me rëndësi parësore ruajtja e autonomisë së garantuar ligjërisht dhe vazhdimi i bashkëpunimit të besueshëm dhe të qetë midis organeve të ndryshme drejtuese dhe niveleve organizative të Universitetit. Përveç kësaj, të gjithë anëtarët e Universitetit duhet të integrohen siç duhet në procesin vendimmarrës në përputhje me Ligjin dhe autonominë universitare.

Mbi të gjitha, për të arritur objektivat e tij, Universiteti i Tiranës, si institucioni kryesor publik i arsimit të lartë në Shqipëri, ka nevojë për fonde të mjaftueshme dhe të qëndrueshme nga Qeveria dhe donatorë të tjerë për të qenë në gjendje t'i përdorë ato në mënyrë efikase, të drejtë dhe për të siguruar stabilitet financiar dhe institucional si dhe për të mbështetur të gjitha objektivat e vendosur në këtë Strategji.



1. Përmirësimi i arsimit dhe novacionit të studimeve

Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron një gamë të plotë programesh studimi Bachelor, Master dhe Doktoratë, duke u ofruar studentëve një qasje të gjerë në to. Programet e studimit të UT-së ndajnë qëllimet e zhvillimit të arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, dhe përgatitjes së brezit të ri me njohuri, kapacitete dhe aftësi bashkëkohore, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e një shoqërie demokratike dhe shtetit të së drejtës për rritjen e mirëqenies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara nëpërmjet aktiviteteve të ligjshme dhe transparente.

Me qëllim tërheqjen e më shumë studentëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë si dhe personelit akademik, Universiteti është i angazhuar për të rritur numrin e programeve të studimit që do të ofrohen në gjuhën shqipe dhe angleze, veçanërisht në ciklet e studimit Master dhe Doktoratë. Për më tepër, Universiteti ka për qëllim të tërheqë dhe të përfshijë më shumë grupe interesit, duke përfshirë komunitetin e biznesit në zhvillimin dhe zbatimin e programeve novatore të studimit në të gjitha nivelet e studimeve. Qëllimi i kësaj qasjeje nuk është tjetër veçse të ofrojë më shumë mundësi për studentët dhe t'i pajisë ata me aftësi për të pasur sukses si profesionistë në tregun e punës, si dhe si qytetarë të angazhuar në shoqëri. Në këtë drejtim, UT-ja ka miratuar një Strategji Institucionale mbi Mësimdhënien e Universitetit të Tiranës (2022-2027) e cila krijon kuadrin për ecurinë e Universitetit në periudhën e ardhshme.

Të gjitha programet e studimit në UT kanë si emërues të përbashkët: nxitjen e mendimit kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frysës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike universitare të karakterizuar nga debati i lirë, serioz dhe përkushtimi për të mirën publike. UT-ja e konsideron veten si një institucion që synon, nëpërmjet programeve të studimit, të orientojë studentët drejt mendimit analistik dhe ndërdisiplinor dhe t'i përgatisë ata për konkurrencë në tregun e punës. Në të njëjtën kohë, UT-ja vë një theks të veçantë në tërheqjen e studentëve me rrethana të pafavorshme dhe personave me nevoja të veçanta nëpërmjet përmirësimit të strukturave infrastrukturore dhe politikave të mbështetjes financiare.

1.1 Objektivat specifikë:

- 1.1.1. Të nxisë ekselencën në arsim nga një personel akademik i angazhuar në UT;
- 1.1.2. Të lidhë programet e studimit me tregun e punës dhe të nxisë përfshirjen aktive të komunitetit të biznesit në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të studimit;
- 1.1.3. Të hartojë më mirë rezultatet e të mësuarit në procesin mësimor dhe të ofrojë kurrikula të bazuara në kompetencia nëpërmjet programeve novatore të studimit;
- 1.1.4. Të ofrojë më shumë mundësi për studentët, duke përfshirë përmirësimin e kompetencave të tyre shoqërore dhe personale;
- 1.1.5 Të mbështetë studentët me një mesatare mbi 8;
- 1.1.6. Të zhvillojë dhe të promovojë programe me mësim të shkurtër, programe të bëra në mënyrë të veçantë dhe programe të tjera mikro-kredenciale;
- 1.1.7 Të zhvillojë dhe mbështetë zhvillimin e dimensionit social, si pjesë integrale e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor.



1.1.8 Të zhvillojë dhe mbështesë politikat dhe aktivitetet e të mësuarit gjithëpërfshirës dhe gjatë gjithë jetës.

1.1.9 Të zhvillojë dhe mbështesë “smart specialisation S3” në të gjithë komponentët e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Përbushja e objektivave specifikë do të vlerësohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit të elementeve të mëposhtme:

Treguesit

Nr.	Treguesi	Viti 1	Viti 5
1.	Rritja e personelit me orar të plotë të punësuar në UT, duke respektuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm në kuadër të titujve akademikë (preferencë u jepet njësive që térheqin numër më të lartë studentësh)	+1% në vit	+5%
2.	Krijimi i bashkëpunimit me kompanitë me qëllim të mësimdhënies praktike, praktikave dhe formave të tjera të bashkëpunimit universitaro-ekonomik (në varësi të numrit të studentëve) ¹	Të paktën 30 kompani për universitet	Të paktën 150 kompani për universitet
3.	Përfshirja e kompanive në zhvillimin/përditësimin e programit të studimit	Të paktën 30 kompani për universitet	Të paktën 150 kompani për universitet
4.	Pjesëmarrja e studentëve në të gjitha ciklet e studimit në kërkimin shkencor në UT	Të paktën 30 studentë për universitet	Të paktën 100 studentë për universitet
5.	Pjesëmarrja e studentëve në kurset e zhvillimit të aftësive profesionale nga UT-ja duke përfshirë Qendrën/at e Karrierës dhe trajnimet e organizuara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT.	Të paktën 5% e studentëve për universitet	Të paktën 20% e nxënësve për universitet
6.	Pjesëmarrja e personave me doktoratë, post-doktoratë dhe profesorëve në trajnimet e zhvillimit profesional duke përfshirë novacionin në mësimdhënie, ngritjen e kapaciteteve për përgatitjen e projekteve dhe aftësitë në TIK	Të paktën 10% për universitet	Të paktën 50% për universitet
7.	Zhvillimi i një programi studimi të ofruar tërësisht në gjuhën angleze	Të paktën 5 për universitet	Të paktën 15 për universitet
8.	Zhvillimi i programit të studimit në distancë të ofruar tërësisht online	Të paktën 1 për universitet	Të paktën 3 për universitet
9	Hapja e programeve të përbashkëta	Të paktën 1 për universitet	Të paktën 4 për universitet

¹ Institucionet publike dhe private, organizatat jo fitimprurëse, sektori i biznesit, etj.



Masa konkrete

Nr.	Treguesi	Afati i fundit
1.	Zhvillimi dhe funksionimi i sistemit E-integrated për menaxhimin e dosjeve studentore, pikët, pagesat e tarifave, shpërndarjen e informacionit etj.	Viti 2
2.	Përmirësimi i infrastrukturës në shërbim të arsimit, kërkimit shkencor dhe novacionit, si dhe shërbimeve për të tretët dhe komunitetin.	Viti 3
3.	Procedurë e thjeshtuar e njohjes së ECTS-ve të përfshuar nga studentët nëpërmjet programeve të studimit jashtë vendit	Viti 2
4.	Zhvillimi i një rregulloreje specifike për njohjen e mobiliteteve të nxënësve.	Viti 1
5.	Nxitje përfutjen e programeve mësimore online në legjislacionin shqiptar.	Viti 2



2. Rritja e ndërkontaktuarizimit dhe lëvizshmërisë

Ndërkontaktuarizimi në arsimin e lartë është bërë një prirje dominuese si një përgjigje proaktive ndaj mundësive, sfidave dhe rreziqeve që shoqërojnë globalizimin. Studentët tërhiqen nga mundësitë për të jetuar dhe studiuar jashtë vendit. Prandaj, ndërkontaktuarizimi i kurrikulave luan një rol kritik në formimin e kompetencave globale, duke kontribuar në dimensionin ndërkulturor të përbajtjes së planeve dhe programeve të studimit, aq të nevojshme në përgatitjen konkurruese të studentëve që duhet të janë në gjendje të punojnë në një botë me ndërvarësi globale në rritje.

Universiteti i Tiranës është universiteti lider në Shqipëri për të zbatuar procesin e ndërkontaktuarizimit brenda sistemit të tij akademik. Në këtë kuptim, Universiteti ka miratuar një dokument të veçantë - Strategjinë e Ndërkontaktuarizimit të Universitetit të Tiranës për periudhën 2021-2026.

Ky fenomen tani është i dukshëm në disa segmente duke përfshirë: rritjen e lëvizshmërisë së UT-së dhe studentëve, zgjerimin e rrjeteve ndërkontaktare të kërkimit shkencor, bashkëpunimin midis fakulteteve të ngashme që ofrojnë diploma të dyfishta, pjesëmarrjen në sistemet ndërkontaktare të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, renditjen globale etj. Në këtë perspektivë, ndërkontaktuarizimi përfaqëson një instrument vendimtar për përmirësimin e imazhit institucional duke garantuar një cilësi në rritje të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkontaktar, Universiteti i Tiranës mbetet i angazhuar për përdorimin e mëtejshëm të bashkëpunimit shkencor shumëpalësh në kuadër të programeve të BE-së (Erasmus+, Horizon Europe), programit CEEPUS si dhe mundësive të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe. Duke pasur parasysh faktin se bashkëpunimi ndërkontaktar në fushën e kërkimit shkencor është një nga kriteret e integrimit në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor - ERA, Universiteti i Tiranës vazhdon të shqyrtojë dhe inkurajojë nënshkrimin e memorandumeve dypalëshe dhe marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor dhe novacionit me universitete prestigjoze me qëllim zgjerimin e portofolit të programeve bashkëpunuese me cilësi të lartë me partnerë strategjikë.

2.1 Objektivat specifikë:

2.1.1. Të zhvillojë partneritete dhe bashkëpunime strategjike afatmesme dhe afatgata me universitetet kryesore në Bashkimin Evropian dhe Ballkanin Perëndimor;

2.1.2 Të mbështetë dhe të nxitë lëvizshmërinë e studentëve dhe personelit të UT-së dhe të tjerëqë studentë ndërkontaktarë dhe personel akademik dhe

2.1.3 Të rritë pjesëmarrjen e UT-së në projekte, nisma, rrjete dhe shkëmbime ndërkontaktare.

Përbushja e objektivave specifikë do të vlerësohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit të elementeve të mëposhtme:

Treguesit:

Nr.	Treguesi	Viti 1	Viti 5
1.	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara të partneritetit (përfshirë programin Erasmus+) me universitetet në Bashkimin Evropian dhe Ballkanin Perëndimor	+5% në vit	+25%



2.	Numri i studentëve të UT-së që marrin pjesë në mobilitete jashtë vendit	Të paktën 70 studentë për universitet në vit	Të paktën 350 studentë për universitet
3.	Rritja e numrit të studentëve të huaj që ndjekin programet në UT në çdo cilësi	Të paktën 30 nxënës për universitet	Të paktën 120 studentë për universitet
4.	Rritja e pjesëmarrjes së personelit akademik dhe administrativ në veprimtaritë ndërkombëtare jashtë vendit	+10%	+30%
5.	Rritja e përfshirjes së personelit ndërkombëtar përfshirë diasporën shqiptare në leksione, Komisione për mbrojtjen e tezave në Master dhe doktoraturës	Të paktën 10 profesorë për universitet	Të paktën 50 profesorë për universitet

Masat konkrete:

Nr.	Treguesi	Afati i fundit
1.	Procedura të thjeshtuara dhe bashkëpunim më të mirë midis palëve të përfshira për të reduktuar vonesat brenda Universitetit (në procesin e aplikimit për projekte, zbatimin e projekteve, prokurimet).	Viti 2
2.	Nismë dhe propozim për procedura të thjeshtuara kombëtare për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve në projekte ndërkombëtare/kombëtare. ²	Viti 1
3.	Fushatë promovuese dhe kontakti për të mbështetur përfitimet e lëvizshmërisë	Viti 1
4.	Zhvillimi i planit përritjen e bashkëpunimit me universitetet në rajon	Viti 1

² Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve në Universitetin e Tiranës bazohet në Ligjin shqiptar të prokurimit dhe lidhur me projektet ndërkombëtare bazohet në procedura konkrete të se cilës marrëveshje specifike.



3. Përparimi i kërkimit shkencor dhe mbështetja e novacionit përmes qendrave të shkëlqyera kërkimore dhe përmirësimit të renditjes së Universitetit

Qëllimi i kërkimit shkencor në Universitetin e Tiranës është përgatitja e specialistëve shqiptarë që do t'i shërbenin vendit dhe do të ishin në gjendje të manovronin në një botë gjithnjë në ndryshim. Që nga themelimi, kërkimi shkencor përfaqëson një nga dimensionet kryesore të veprimitarës së Universitetit të Tiranës.

UT-ja synon të bëhet një udhëheqës i kërkimit, duke mundësuar përfitimin e shoqërisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjatë periudhës së aplikimit të Strategjisë së Zhvillimit, bazuar në traditat jetëgjata të Universitetit për sa i përket lirisë akademike dhe autonomisë, do të promovohet një kulturë kërkimore, e karakterizuar nga roli i rëndësishëm i novacionit. Përveç kësaj, Universiteti i Tiranës synon të zhvillojë aftësinë për të shpërndarë njojuritë kërkimore dhe rezultatet e kërkimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në krijimin e politikave dhe rritjen ekonomike dhe duke kontribuar në mënyrë efektive në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike të shoqërisë.

3.1. Objektiva specifikë

- 3.1.1. Të përmirësojë renditjen ndërkombëtare dhe dukshmërinë e UT-së;
- 3.1.2. Të rritë financimin për kërkimin shkencor nëpërmjet përthithjes së fondeve publike të siguruara nga burime kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe fondet e UT-së;
- 3.1.3. Të avancojë cilësinë e rezultateve të kërkimit shkencor dhe të promovojë personelin akademik me historik të jashtëzakonshme publikimesh dhe
- 3.1.4. Të përforcojë bashkëpunimin midis komunitetit shkencor dhe sektorit privat.
- 3.1.5. Të mbështetë përpjekjet dhe aktivitetet e novacionit/ pikat e novacionit.

Përbushja e objektivave specifikë do të vlerësohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit të elementeve të mëposhtme:

Treguesit

Nr.	Treguesi	Viti 1	Viti 5
1.	Rritja e fondeve për pagat e personelit akademik dhe administrativ të shqar	Siq përcaktohet në plan	Siq përcaktohet në plan
2.	Rritja e fondeve institucionale për kërkimin shkencor	+2-3% në vit	+10-15%
3.	Numri i artikujve të indeksuar në bazat e të dhënavë shkencore përkatëse (Scopus, Ëeb of Science etj.) botuar nga personeli akademik i UT-së	+10% në vit	+50%
4.	Numri i aplikimeve të paraqitura për financimin e projekteve nga donatorët/ programet kombëtare	5 aplikime për universitet	15 aplikime në vit për universitet
5.	Rritja e numrit të kërkesave të paraqitura për financim të projekteve	Të paktën 5 aplikime për universitet	Të paktën 15 aplikime për universitet



	nga donatorët/ programet ndërkontinentale si aplikues kryesor		
6.	Rritja e numrit të kërkuesave të paraqitura për financim të projekteve nga donatorët/ programet ndërkontinentale si bashkëpërdorues	Të paktën 5 aplikime për universitet	Të paktën 25 aplikime për universitet
7.	Numri i librave të botuar/ monografive të personelit të mbështetur nga UT-ja dhe të përgjedhur përmes një procedure transparente (në varësi të numrit të personelit akademik)	+5 monografi në vit	+25 monografi për universitet
8.	Numri i artikujve të botuar në revistat e renditura në Scopus, Journal Citation Reports dhe Ëeb of Science. (në varësi të numrit të personelit akademik)	20 artikuj në vit	100 artikuj
9.	Numri i projekteve kërkimore të zhvilluara/zbatuara në bashkëpunim me sektorin privat	Të paktën 5 projekte për universitet	Të paktën 25 projekte për universitet
10.	Blerja e softuerëve specifikë të licencuar (SPSS, STATA, NVivo, etj.)	1 në nivel universitar	5 në nivel universitar
11.	Krijimi i një Qendre të Sigurisë Kibernetike	1 në nivel universitar	1 në nivel universitar
12.	Trajnime të organizuara për aplikime për të fituar një Patentë	1 në nivel universitar	5 në nivel universitar

Masa konkrete

Nr.	Treguesi	Afati i fundit
1.	Sistemi anti-plagiaturë plotësisht operacional, për të filluar vlerësimin paraprak me tezat Master dhe për të vazhduar me tezat e doktoratës dhe dokumentet kërkimore	Viti 2
2.	Zhvillimi i politikave të dukshmërisë institucionale për kërkimin shkencor në UT	Viti 2
3.	Përmirësimi i infrastrukturës në shërbim të arsimit, kërkimit shkencor dhe novacionit, si dhe shërbimeve për të tretët dhe komunitetin.	Viti 1
4.	Plani për popularizimin e kërkimit shkencor dhe ndikimin e tij në shoqëri	Viti 2
5.	Përgatitja e Raportit Vjetor të UT-së mbi pjesëmarrjen e personelit të UT-së në aktivitetet kërkimore ndërkontinentale (projekte, konferenca,ëorkshope dhe publikime) duke përfshirë burimet e financimit	Viti 1
6.	Promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të viteve sabatike nga personeli akademik	Viti 3
7.	Krijimi i partneritetit me qendrat e novacionit	Viti 2



4. Përforcimi i angazhimit shoqëror, shtrirjes dhe dukshmërisë

Universiteti i Tiranës kontribuon në zhvillimin e shoqërisë nëpërmjet tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: arsimit, kërkimit shkencor, si dhe shërbimit ndaj publikut, të cilat vazhdimisht pasurojnë dhe informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet ndjekjes, përhapjes dhe zbatimit të njohurive. Krijimi i një komuniteti të qëndrueshëm studentor dhe akademik përforcon misionin e UT-së për të kryer mësimdhënie dhe kërkim dhe për të gjetur dhe ofruar zgjidhje për çështje të ndryshme në botën akademike dhe më gjérë.

Angazhimi shoqëror sigurohet nëpërmjet një vizioni holistik për një akademi të qëndrueshme që nxit lidhjet ndërdisiplinore për novacionin, një lidhje më të ngushtë të studentëve me fakultetin dhe partneritete me të tjerë grupe interesit dhe përfitues. UT-ja është e hapur për gjenerimin e ideve, novacionit dhe zbulimit.

Duke pasur parasysh këtë, në vitin 2022 UT-ja ka miratuar një Dokument të posaçëm mbi politikat e komunikimit me studentët dhe publikun i cili shtron parimet bazë të komunikimit me grupet e synuara.

Universiteti i Tiranës synon të ketë ndikim mbi shoqerinë nëpërmjet aktiviteteve të tij në veçanti duke arsimuar novatorët e rindërtuar, duke paraqitur gjetjet e hulumtimit tek publiku i gjërë dhe gjithashtu nëpërmjet rritjes së aktiviteteve të transferimit të njohurive dhe projekteve të bashkëpunimit me ekonominë. Për më tepër, UT-ja riafirmzon angazhimin e saj për t'u angazhuar aktivisht me biznesin dhe industrinë dhe për të ofruar mundësi për ndërveprim me komunitetin e saj të alumnive, në mënyrë që të udhëheqë qasjen sipërmarrëse për të ardhmen.

4.1. Objektivat specifikë

4.1.1 Të përforcojë shtrirjen publike, informimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me UT-në dhe të promovojë Universitetin si qendër intelektuale e Shqipërisë;

4.1.2. Të riangazhohet me komunitetin e alumnive me qëllim të nismave të reja;

4.1.3 Të bashkëpunojmë aktivisht me sektorin e biznesit në mënyrë që të udhëheqë qasjen sipërmarrëse për të ardhmen

4.1.4. Të promovojë format e reja të bashkëpunimit me sektorin privat dhe publikun e gjërë në fushën e sportit, angazhimit të rindërtuar, vullnetarizmit, mbrojtjes së mjedisit dhe

4.1.5. Të lehtësojë më mirë transferimin e njohurive, të përshtatur me nevojat e tregut të punës.

Përmbytja e objektivave specifikë do të vlerësohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit të elementeve të mëposhtme:

Treguesit

Nr.	Treguesi	Viti 1	Viti 5
1.	Numri i ndjekësve të llogarive të mediave sociale të UT-së	+10% në vit	+50%
2.	Numri i alumnive të regjistruar në bazën e të dhënavë të UT-së	Të paktën 500 Alumni në vit për universitet	Të paktën 2000 Alumni për universitet
3.	Numri i evenimenteve të organizuara me alumni (me të paktën 30 alumni)	5 evenimente për universitet	20 evenimente për universitet



4.	Numri i praktikave të realizuara nëpërmjet universitetit	Të paktën 50 studentë	Të paktën 250 studentë
5.	Numri i nismave të vullnetarizmit të zbatuara nga njësítë e UT-së	Të paktën 5 nisma	Të paktën 25 nisma
6.	Numri i formave joakademike të bashkëpunimit të themeluara me sektorin privat, biznesin, industrinë, organizatat qeveritare dhe joqeveritare (seminare trajnimi, forume, novacione industriale dhe teknologjike, start-ups dhe spin-off)	Të paktën 10 në nivel universitar	Të paktën 25 në nivel universitar
7.	Numri i kompanive të përfaqësuara në panairin vjetor të punës	Të paktën 20 kompani në panair	Të paktën 60 kompani në panair

Masa konkrete

Nr.	Treguesi	Afatë i fundit
1.	Përgatitja e Planit Vjetor për punën e Qendrës/ave së Karrierës	Viti 1
2.	Përgatitja e dokumenteve dhe zgjidhja TIK për rrjetin Alumni	Viti 2
3.	Zhvillimi i formave të reja për përhapjen dhe shpërndarjen e rezultateve (neësletter, mobile app, media të tjera sociale etj).	Viti 1
4	Krijimi i një grupei të posaçëm për të bashkëpunuar veçanërisht me sektorin e biznesit për qëllime sipërmarrëse nëpërmjet zbatimit të kurrikulave të reja	Viti 2
5	Rritja e numrit të aplikimeve për projekte sa i përket sipërmarrjes.	Viti 2



5.1.8. Të trajtojë çeshtjet në zhvillim të ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e mjedisit dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm;

5.1.9. Të zbatojë një vlerësim të plotë të pasurive pronësore të Universitetit në përputhje me legjislacionin e pronës.

Përmbytja e objektivave specifikë do të vlerësohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit të elementeve të mëposhtme:

Treguesit

Nr.	Treguesi	Viti 1	Viti 5
1.	Rritja e fondeve pér pagat e personelit akademik të shkëlqyer (metoda e bazuar në meritë)	Siç përcaktohet në plan	Siç përcaktohet në plan
2.	Rritja e fondeve pér abonimin në bazën e të dhënavë	+20%	+50%
3.	Numri i aktiviteteve të reciproke të organizuara midis njësive të ndryshme në UT me qëllim të bashkëpunimit dhe rrjetëzimit	+1 pér njësi	+5 pér njësi
4.	Rritja e numrit të personelit të punësuar në zyrën ndërkombëtare të ngarkuar me mbështetjen e përgatitjes së aplikimeve pér projekte	+2	+5
5.	Rritja e numrit të personelit të punësuar në zyrën e TIK-ut	+2	+5
6.	Rritja e numrit të personelit të punësuar në qendrën pér zhvillimin profesional	+2	
7.	Numri i anëtarëve të të gjitha bordeve, komisioneve dhe drejtimit që ndjekin trajnimin pér të siguruar një qeverisje efektive	Të paktën 20 në nivel universitar	Të paktën 60 në nivel universitar
8.	Numri i personelit akademik që ndjekin trajnimin pér zhvillim profesional duke përfshirë formimin pedagogjik	Të paktën 20 në nivel universitar	Të paktën 60 në nivel universitar
9.	Përmirësimi i balancës gjinore në strukturën e menaxhimit të Universitetit dhe njësisë; Komisionin pér promovimin e personelit akademik dhe Komisionin pér mbrojtjen e tezave Master dhe Doktoratë	+3% në favor të gjinisë më pak të përfaqësuar në nivel universiteti/njësie	+15% në favor të gjinisë më pak të përfaqësuar në nivel universiteti/njësie
10.	Ngritja e çmimit pér studentin dhe profesorin më të mirë bazuar në meritë	+1	+1
11.	Ofertë pér punësimin e studentit/ëve më të mirë në universitet	+1	+5

Masa konkrete

Nr.	Treguesi	Afati i fundit



1.	Plani i veprimit për përmirësimin e strukturave për personat me nevoja të vecanta (nëse është e nevojshme)	Viti 1
2.	Plani i modernizimit (nëse është e nevojshme)	Viti 1
3.	Plani i veprimit për përmirësimin e balancës gjinore në UT	Viti 1
4.	Plani i veprimit për adresimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e mjedisit dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (me masa dhe veprime për të siguruar përputhjen e veprimtarisë së Universitetit me legjislacionin, duke përfshirë kontrolllet për parandalimin dhe reduktimin e shkarkimeve ndotëse në ajër, tokë dhe ujë).	Viti 1



6. Promovimi dhe mbështetja për sigurimin e cilësisë

Roli i sigurimit të cilësisë është i një rëndësie vendimtare në mbështetjen e sistemeve dhe institucioneve të arsimit të lartë në përgjigje të ndryshimeve dhe sfidave të reja, duke siguruar që kualifikimet e arritura nga studentët dhe përvoja e tyre e arsimit të lartë të mbeten në krye të misionit institucional. Universiteti i Tiranës është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në të gjitha fushat e aktiviteteve të tij arsimore dhe kërkimore. Duke qenë një koncept që zbatohet në vitet e fundit, sigurimi i cilësisë është një nga përparësítë më të mëdha që UT-ja po planifikon të trajtojë. Në këtë drejtim, Universiteti udhëhiqet nga kuadri legjislativ kombëtar, rregulloret dhe praktikat ekzistuese institucionale si dhe Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë të Shoqatës Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Së fundi, UT-ja është e angazhuar të monitorojet vazhdimesht treguesit e sigurimit të cilësisë dhe zhvillimit dhe të përgatitë planin e veprimit për të trajtuar mangësitë e identifikuara.

6.1. Objektivat specifike

6.1.1 Të promovojoë përfitimet e një sistemi efektiv për sigurimin e cilësisë për zhvillimin e Universitetit;

6.1.2 Të përmirësojë përfshirjen e palëve të interesuara përkatëse në këtë proces;

6.1.3 Të përforcojë kapacitetet e Universitetit dhe njësive të tij për të zbatuar procesin e sigurimit të cilësisë dhe për të trajtuar në mënyrë efikase mangësitë e identifikuara dhe

6.1.4 Të krijojë "kulturën" e sigurimit të cilësisë në UT.

Përbushja e objektivave specifike do të vlerësohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit të elementeve të mëposhtme:

Treguesit

Nr.	Treguesi	Viti 1	Viti 5
1.	Rritja e përgjithshme e normës mesatare të kënaqësisë në pyetësorët e studentëve	+0,1% (në nivel universitar)	+0,5% (në nivel universitar)
2.	Numri i programeve të studimit që përbushin plotësisht standardet / % e programeve të studimit të akredituara.	+5%	+20%
3.	Rezultatet e shpërndara të pyetësorëve të studentëve në personelin akademik	100%	
4.	Numri i pjesëmarrësve që ndjekin trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të sigurimit të cilësisë	15 në nivel universitar	60 në nivel universitar
5	Numri i projekteve të fituara në çështjet e sigurimit të cilësisë	Të paktën 1 për universitet	Të paktën 3 për universitet
6.	Numri i planeve të veprimit të miratuara për të trajtuar mangësitë e raporteve të vlerësimit të brendshëm	1 për njësi	1 për njësi
7	Numri i lëvizshmërisë së personelit të angazhuar me çështje të sigurimit të cilësisë	Të paktën 5 për universitet	Të paktën 20 për universitet



Masa konkrete

Nr.	Treguesi	Afati i fundit
1.	Futja e një sistemi individual të menaxhimit të performancës	Viti 2
2.	Prezantimi i vlerësimit 360 gradë	Viti 2
3.	Raport mbi rezultatet e vlerësimit dhe planin e veprimit për të trajtuar dobësitë e publikuara (nivel njësie)	Viti 1
4.	Themelimi i një organi kompetent përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë së Zhvillimit	Viti 1

